



PROCESVERBAL

Me qëllim të aplikimit në Ministria e Zhvillimit Rajonal për financimin e një projekti në fshatin Nerodime e Ulët, është organizuar një diskutim publik me qytetarët e Ferizajt, përkatësisht me banorët e fshatit Nerodime e Ulët.

Takimi është mbajtur më 20 maj 2026, në sallën e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, ku kanë qenë të pranishëm 18 pjesëmarrës.

Komuna e Ferizajt ka siguruar parcelën për ndërtimin e këtij projekti.

Diskusimin e hapi z.Balton Dërguti-Drejtor I Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në Komunen e Ferizajt, i cili prezantoi në pika të përgjithshme projektin në fjalë.

Qytetarët e mirëpritën realizimin e këtij projekti. Z.Bedri Aliu kërkoi që pjesë përbërëse e projektit të jetë edhe rregullimi i kronit të fshatit, i cili sipas tij nuk kërkon buxhet të madh, por është shumë i nevojshëm për banorët.

z.Adnan Hyseni vlerësoi se realizimi i këtij projekti është shumë i rëndësishëm për këtë zonë dhe se, përveç banorëve lokalë, projekti do të mund të shfrytëzohet edhe nga qytetarët e tjerë, duke qenë se paraqet një investim funksional dhe të dobishëm.

z.Avni Nuhaj theksoi se realizimi i projektit është i qëlluar dhe falënderoi Komunën e Ferizajt për angazhimin dhe interesimin e saj për investime në këtë zonë.

z.Remzi Salihu potencoi se projekte të tilla, si ai i prezantuar nga Komuna e Ferizajt, janë të mirëseardhura për banorët e kësaj zone. Ai shtoi se nuk sheh pengesa për realizimin e tij, duke qenë se parcela është pronë komunale dhe se investimi do të shfrytëzohet për aktivitete sportive dhe rekreative në interes të komunitetit.

z.Artan Azizi propozoi që në kuadër të projektit të parashihet ndërtimi i fushave multifunkionale për aktivitete sportive si futboll, basketboll, volejbolli dhe tenisi etj.Gjithashtu, ai kërkoi që të planifikohet edhe ndriçimi publik me energji solare, me qëllim të uljes së kostove financiare dhe mirëmbajtjes nga ana e Komunës së Ferizajt.


z.Ekrem Bajrami vlerësoi se projekte të tilla janë pozitive dhe të pranueshme për qytetarët, mirëpo kërkoi që të sigurohet edhe furnizimi me ujë në parcelë, në mënyrë që hapësirat gjelbëruese të mirëmbahen dhe të zhvillohen siç duhet, përfshirë ruajtjen e pemëve, barit dhe elementeve të tjera dekorative.

Po ashtu, ai propozoi që të realizohen konsultime me biologë dhe ekologë, me qëllim të përcaktimit të saktë të llojeve të drunjve dhe kulturave që duhet të mbillen, duke siguruar kështu jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Ky takim ka përfunduar në orën 11:00.

Procesverbal i datës: 20/05/2026

Procesmbajtës

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Asmir Azemi', written over a horizontal line.

Asmir Azemi